

RUAJMË




SHËNDETIN TONË

RËNDËSIA E DEMOKRACISË

LEART (11), LOENA (11), ALTUNA (11), ERDA (10), BLERTINA (10), BENETA (11), DRIT (10), BLEND (11),

KONDOR (11)



Në këtë artikull mund të gjeni fakte mbi demokracinë dhe shembuj nga jeta e përditshme se për mënyrën se si ndikon ajo në jetën tonë

Në shtetin tonë jemi diku rreth 1.8 milion banorë. Nuk jemi shtet edhe aq i madh, por diversitet kemi mjaftueshëm.

Në Kosovë jetojnë qytetarë të komuniteteve të cilët kanë prejardhje të ndryshme etnike. Mirëpo, a paraqet kjo problem për ne? Jo, asnjëherë. Përpos etnicitetit, ne kemi edhe dallime fetare. Për shembull, ne qytetarët e Kosovës u takojmë feve të ndryshme. Gjithsesi, as ky fakt asnjëherë nuk na ka penguar. Ne jetojmë dhe punojmë të gjithë së bashku. E tërë kjo falë demokracisë, sistemit më të mirë të qeverisjes. Jo gjithmonë mund të jemi të mendimeve apo bindjeve të njëjta me të gjithë. Por, ne në çdo rrethanë duhet ta respektojmë mendimin e tjetrit, sepse mendimet e të gjithëve vlenjë. E respekti, barazia janë elemente të demokracisë. Elementet e saj nuk përfundojnë me kaq. Solidariteti, drejtësia, paqja, toleranca janë gjithashtu elemente të demokracisë. Këto elemente janë aq të mira dhe të rëndësishme, sa e tërë jeta jonë bazohet në to. Dhe në fakt, nëse ne nuk jetojmë me këto elemente, atëherë jeta jonë nuk do të ishte edhe aq e këndshme.

Demokracia si sistem i qeverisjes për herë të parë është paraqitur në kryeqytetin e Greqisë në Athinë. Nga vetë fjala demokraci kuptohet se ne qytetarët e kemi fjalën përfundimtare, dhe ne udhëheqim, përmes

votave tona. „Demos“ nga gjuha greke nëse përkthehet në shqip nënkupton popull. Ndërsa, „kratia“ udhëheqje. Pra, udhëheqje nga populli.

Demokracia ka kaq shumë vlerë për ne. Kjo është shumë e rëndësishme për t'u kuptuar. Për këtë arsye, shumë organizata kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes në lidhje me demokracinë. Marrim organizatën TOKA si shembull. Kjo organizatë përmes projektit „Demoti“ është duke bërë shumë për vendin tonë. Ky projekt ngrit vetëdijen e qytetarëve për rëndësinë e demokracisë në jetën e të gjithë neve. Andaj, ju lutemi të mos harroni se çdo veprim i yni ndikon tek të gjithë. Të jemi të kujdesshëm, të punojmë mirë, ta respektojmë njëri-tjetrit, ta ndihmojmë njëri-tjetrin, nëse duam të kemi një jetë sa më të mirë dhe demokratike. Ne do ta ruajmë dhe do të punojmë për demokracinë tonë. Bëhuni edhe ju si ne.



Sot si kurrë më parë, gazetarë të demokracisë

VOTA, E DREJTË E TË GJITHËVE

ERZA (11), IDOL (11), ELKIDA (11), ENES (11), GEAT (11), ENGJËLL (11), ONDIN (11), ELONA (11), ELDA (11)



Shteti ynë Kosova është vend demokratik. Prandaj, të gjithë qytetarët e kanë të drejtën e votës, sepse zgjedhjet e lira janë zemra e demokracisë

Ne, të cilët jetojmë në një vend demokratik, të gjithë i kemi të drejtat e barabarta. Këto të drejta i kemi të garantuara me ligj. Një nga të drejtat tona themelore është edhe e drejta e zgjedhjes.

Mësuesja e klasës sonë është shumë demokratike ndaj neve si nxënës. Ajo bën shumë aktivitete dhe na përfshin të gjithëve. Po, sepse të gjithë jemi të barabartë. Për shembull, si aktivitet që e zhvillojmë shpesh është zgjedhja e pyetjeve të përgatitura nga mësuesja. Ne si klasë jemi të ndarë në 6 grupe. Secili grup i zgjedh disa pyetje, të cilat pastaj ia parashtron gjithë klasës. Po ashtu, për shkak që secili nga ne është shumë i interesuar në mësimet dhe kemi dëshirë që të përsërisim mësimet, mësuesja i zgjedh 3 apo 4 nxënës. Pastaj, ne me vota e zgjedhim nxënësin, i cili do të vazhdojë përsëritjen e mësimëve.

Në lëndën e edukatës fizike, gjithashtu e kemi mundësinë të zgjedhim aktivitetin apo lojën që e pëlqejmë më shumë. Për shembull: luajmë futboll apo volejbol, zhvillojmë gara me vrapime, etj.

Këta ishin disa nga shembujt kur ne edhe pse fëmijë, kemi të drejtë të zgjedhim dhe të votojmë në jetën tonë të përditshme. Por, jemi ende të vegjël për të votuar në procesin zgjedhor, sepse jemi në klasën e V-të. Kur

do t'i mbushim 18 vjet, atëherë do të kemi mundësi të votojmë përfaqësuesit e vendit tonë.

Në lëndën e edukatës qytetare dhe në projektin „Demo-ti“, kemi mësuar se në Kosovë ndodhin dy lloje të zgjedhjeve, të cilat janë: zgjedhjet parlamentare dhe zgjedhjet komunale. Në zgjedhjet parlamentare populli i voton kandidatët për deputetë, të cilët pastaj nëse votohen nga shumica e popullit, zgjedhen si deputetë. Ata marrin vendime të rëndësishme në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kurse, në zgjedhjet komunale qytetarët votojnë kandidatët për kryetar të komunës dhe asamblistët.

Duke parë rëndësinë e votës, ne pretendojmë se në të ardhmen do të jemi qytetarë shumë të përgjegjshëm dhe do të votojmë në procesin zgjedhor. Vota e secilit ka peshë të madhe. Prandaj, të dashur qytetarë, ju që jeni mbi moshën 18 vjeçare, votoni në procesin zgjedhor. Vota juaj bën ndryshime.




Jemi ata, të cilët do të votojmë mbi moshën 18 vjeçare


Të dashur lexues të kësaj gazete. Ne sot kemi punuar vërtet shumë, sepse kemi qenë gazetarë të Kuvendit të Kosovës. Prandaj, shpresojmë që këto vizatime do t'iu pëlqejnë dhe do të mësoni diçka nga to. Të gjitha përcjellin mesazh të dobishëm në vete. Këtë mesazh, ju lutem kalojeni tek të tjerët




Të gjithë qytetarët të cilët jetojnë në demokraci janë shumë të lumtur. Ata gëzojnë të drejta të barabarta



Pëllumbi simbolizon paqen. E meqë paqja është element i demokracisë, ne e kemi vizatuar një pëllumb



Ky trung është shumë i vlefshëm. Të gjitha elementet e demokracisë janë të shkruara në të



Qytetarët e mirë i ndihmojnë njëri-tjetrit. Për këtë arsye, ne anëtarësohemi në organizata të ndryshme humanitare



Ligjet janë rregulla të cilat duhet të respektohen gjithmonë. Nëse ne nuk kemi rregulla, jeta jonë asnjëherë nuk do të mund të ishte e strukturuar



TË GJITHË QYTETARËT AKTIV

ORGES (11), TUANA (11), ORGETA (11), REIS (11), DARIS (11), VENIS (11), ANILEDI (11), HIRA (11)




Nga ne do të mësoni për qytetarët aktiv dhe punët të cilat kryejnë ata për t'iu ndihmuar të gjithë qytetarëve të tjerë

Të gjithë qytetarët kanë përgjegjësi të jenë aktiv në shtetin u ata jetojnë dhe veprojnë. Ata duhet të bëjnë gjëra të ndryshme, si: punë vullnetare, angazhim në çështjet publike, duhet të marrin pjesë në vendim-marrje dhe të dijnë për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Qytetarët pa dallime kanë obligim dhe përgjeg-

shoqërie më të lumtur. Edhe ne nxënësit si qytetarë aktiv të popullit tonë, kemi ndihmuar shumë njerëz të pastrehë, të moshuar, fëmijë me nevoja të veçanta, etj. Andaj, demokracia ka vlerë të madhe për ne. Ajo është i vetmi sistem i qeverisjes, i cili na jep mundësi të ndërveprojmë lirshëm dhe të ushtrojmë vullnetin tonë të lirë në çdo aspekt të jetës. Fjala demokraci ka vlerë të madhe dhe rëndësi të veçantë për të gjithë qytetarët aktiv. Ju e dini se demokracinë e kanë zhvilluar ndër vite qytetarët aktiv, andaj le të jetë ky artikull një shtytje përpara drejt vetëdijësimit të çdo qytetari se si të bëhet aktiv për veten dhe popullin.

Me këto fjalë që ne shkruam, duam të potencojmë se aktiviteti është ai që i dallon qytetarët në mes vete. E nëse duam shtet të zhvilluar, nëse duam harmoni mes qytetarëve, nëse duam tolerancë dhe paqe, duhet ta zhvillojmë demokracinë përmes qytetarisë aktive. Le të punojmë për të mirën e përbashkët.



Sepse kështu e kërkon demokracia

jësi të paguajnë taksat, pasi nga taksat tona formohet më pas buxheti i shtetit. Nga ky buxhet paguhen pastaj edhe mediat publike të cilat shërbejnë si mjete informimi.

Qytetar aktiv nuk mund të jem vetëm unë, por mund të jesh edhe ti, ai, ajo dhe të gjithë ne. Punët vullnetare e ndihmojnë shtetin që të zhvillohet ekonomikisht. Zhvillim ky që ndihmon pastaj edhe në krijimin e një



Shembull i denjë i gazetarëve punëtorë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Selami Hallaçi“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-6
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjilan